

## NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

**Titulli :** Konsultim me publikun për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet

**Propozuesi :** Kryetari i Bashkisë.

**Qëllimi:** Ky bashkëbisedim me banorët e Bashkisë Përmet ka për qëllim, mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Përmet, si

- Sugjerimi i vendosjes së orarit të hedhjes së mbetjeve në PGM nga familjarët-bizneset etj.
- Ndarja e mbetjeve urbane në burim.
- Riciklimi.
- Ngritja e kapaciteteve për sektorin e pastrim-gjelberimit me vizionin për një qytet sa më të pastër dhe konform standarteve që kërkohen nga legjislativi në fuqi.

**Sqarime:** Konsultimi publik në lidhje me menaxhimin e mbetjeve urbane, sugjerimin për orarin e hedhjes në PGM, ndarja në burime të tyre, riciklimi, performanca e Ndermarjes së pastrim-gjelberimit, dhe ndryshimin e tarifës së pastrimit në vitet në vijim e cila bazohet mbi të dhënat e analizës së detajuar të trajtimit aktual të mbetjeve urbane, si dhe në zbatim të legjislativitetit në fuqi. Bashkia Përmet nuk ndodhet në kushtet e emergjencës të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe njëkohësisht, të gjetjes së zgjidhjes për trajtimin e mbetjeve urbane bazuar në standartet e menaxhimit të integruar të mbetjeve si rezultat i ndryshimit të destinacionit të venddepozitimit të tyre (landfill Bakaj Delvine) që shoqërohet me një rritje të kostos për transportin e mbetjeve urbane.

**Kalendari i konsultimit:** Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në ambientet e sallës së Qendres Kulturore Multifunktionale, kati i II të (ish shtëpia e oficerëve) në **datë 26/08/2022, ora 11:00.**

Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në linkun e mëposhtëm.

[bashkiapermet@gmail.com](mailto:bashkiapermet@gmail.com)

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura deri më datë **29/08/2022**, në adresat e emailëve:

[bashkiapermet@gmail.com](mailto:bashkiapermet@gmail.com)    [jaupiarjan@gmail.com](mailto:jaupiarjan@gmail.com)

**Pjesëmarrës:**

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, drejtues/punonjës të administratës, drejtorja e buxhetit dhe financës, sektori i tatimit taksave, Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët e Njësive Administrative.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Përmet, anëtarët e shoqërisë civile, komuniteti i biznesit, medias, etj.

**Format e konsultimit:** Takim në terren me banorët e Bashkisë Përmet.

|  |   |
|--|---|
|  | Konsultimi me publikun synon:                               |
|  | 1- Njohja me analizen e detajuar të menaxhimit të mbetjeve; |

|                                     |   |
|-------------------------------------|---|
| <p>Qëllimi i këshillimit publik</p> | <ol style="list-style-type: none"> <li>2- Konsultimi i draft rregullores për menaxhimin e mbetjeve;</li> <li>3- Sugjerimin për orarit të hedhjes së mbetjeve urbane në PGM nga familjaret dhe bizneset.</li> <li>4- Ndarja e mbetjeve urbane në burim.</li> <li>5- Riciklimi.</li> <li>6- Ngritja e kapaciteteve për sektorin e pastrim-gjelberimit lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe monitorimin e shërbimit të pastrimit.</li> </ol>  |
| <p>Përshkrimi i çështjes.</p>       | <p>Menaxhimi i integruar i mbetjeve është një nga shërbimet publike më të rëndësishme që siguron mbrojtje më të mirë të mjedisit dhe të shëndetit të banorëve, si dhe zë peshë në buxhetin e përgjithshëm të bashkive. Ai lidhet me një sërë çështjesh të mënyrës së jetesës urbane, konsumit, punësimit dhe të ardhurave të banorëve, si dhe me faktorë të tjerë socio-ekonomik dhe kulturor.</p> <p>Karakteristika e menaxhimit të mbetjeve është se qëndrueshmëria e shërbimit arrihet vetëm nëse Bashkia ka kapacitetet teknike, organizative dhe burimet financiare të nevojshme.</p> <p>Konsultimi me publikun do të bëhet duke u mbështetur në punën konkrete të pastrimit të mbetjeve urbane mbi oraret e mbledhjes së mbeturinave, si për zonën urbane dhe për atë rurale, ditëve të pastrimit; është kontrolluar cilësia e pastrimit dhe dizinfektimi të vendgrumbullimeve, fshirja dhe larja e rrugëve dhe shesheve kryesore; komunikimi me banorët e zonës, nëse në perceptimin e tyre realizohet shërbimi i monitorimit rregullisht dhe ditët e largimit të mbetjeve.</p> <p>Nisur nga fakti që shërbimi bazë i pastrimit është zbrasje dhe fshirje kontenerësh si dhe fshirje e larje/lagje e rrugëve (me shërbim të shtuar në muajt e verës) për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbrasjen e kontenerëve</li> <li>• dhe fshirja/larja e rrugëve</li> </ul> <p>Për të dhënë zgjidhje situatës së menaxhimit të mbetjeve që gjenerohen në Bashkinë e Permetit, pas mbylljes së fushës së mbetjeve në Kutal, aktualisht depozitimi bëhet në venddepozitimin e përkohshëm në Piskovë. Depozitimi i mbetjeve në këtë zonë sjell rritjen e kostos për transportin e mbetjeve deri në këto fushe por depozitimi i përfundimtar i tyre në <b>landfillin e Delvines</b> do të ketë një vlerë akoma më të lartë. Kjo rritje vjen për shkak të distancës më të gjatë të rrugës për në Zonën e Trajtimit të mbetjeve në Piskovë dhe tarifës së transportit të depozitimit të mbetjeve. Për këtë, Bashkia do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve për mënyrën se si janë trajtuar mbetjet urbane deri tani, nivelin e arritjes së objektivave të shërbimeve, si dhe listën me shërbime / funksioneve nga e cila komuniteti përzgjedh ato shërbime për të cilat mendon se bashkia duhet të shpenzojë më shumë gjatë viteve të ardhshme për përmirësimin e shërbimit.</p> |

|  |   |
|--|---|
| <p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p>  | <p>Komentet dhe rekomandimet tuaja mund te jepen në adresat e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për Konsultimin me Publikun, <b>brenda datës 29/08/2022.</b><br/> <a href="mailto:keshilibashkiakpermet@gmail.com">keshilibashkiakpermet@gmail.com</a><br/> ose ne adresen:<br/> <a href="mailto:bashkiapermet@gmail.com">bashkiapermet@gmail.com</a>    <a href="mailto:jaupiarjan@gmail.com">jaupiarjan@gmail.com</a><br/> Adresa: Permet.</p>   |
| <p>Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme</p>   | <p>Opsionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga Administrata e Bashkise sektoret pergjegjes dhe ne perfundim draftet do te miratohen nga ana e Këshillit : Ndryshime në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Orarin e hedhjes se mbetjeve urbane ne PGM</li> <li>➤ Ndarjen e mbetjeve urbane ne burim</li> <li>➤ Riciklimi.</li> <li>➤ përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.</li> </ul>   |
| <p>Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.</p>   | <p>Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në linkun:<br/> <a href="mailto:bashkiapermet@gmail.com">bashkiapermet@gmail.com</a></p>  |
| <p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Administrata e Bashkise për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit.</p> | <p>Dërgimi i sugjerimeve të komunitetit do të jetë i mundur deri në <b>29/08/2022</b> , nëpërmjet adresave të emailit:<br/> <a href="mailto:bashkiapermet@gmail.com">bashkiapermet@gmail.com</a>    <a href="mailto:jaupiarjan@gmail.com">jaupiarjan@gmail.com</a><br/> Pas mbledhjes së rekomandimeve, Administrata e Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizimin nga ana e Sektoreve pergjegjes i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;</li> <li>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Keshillit të Bashkise çdo këshilltari, sektorit të Financës, taksave dhe tarifave;</li> <li>3. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt rregulloren e menaxhimit te mbetjeve.</li> <li>4. Diskutimi dhe miratimi i rregulores se menzxhimit te mbetjeve në <b>seancën e hapur</b> të Mbledhjes së Këshillit Bashkise;</li> <li>5. <b>Informimi i komunitetit</b>, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;</li> <li>6. <b>Publikimi</b> i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;</li> <li>7. <b>Njoftimi</b> i administratës për aktin e miratuar;</li> <li>8. <b>Monitorimi</b> i zbatimit të tij.</li> </ol> |
| <p>Data e publikimit</p>   | <p><b>25/08/2022</b></p>  |